



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:195363

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06512932

KPPP.nr. 1065/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Umbrella Consulting” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811514050 dhe seli në Prishtinë, rr. “Arben Xheladini”, kundër debitorit WBS L.L.C., me numër unik identifikues 811988031 dhe seli në Prishtinë, rr. “Halil Orana”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 245/24 të datës 11.06.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj me zyre në Prishtinë, jashtë seancës me datën 26.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit WBS L.L.C. me seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 245/24 i datës 11.06.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Umbrella Consulting” Sh.P.K., me datë 11.06.2024, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 245/24, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit: Faturës nr. 0204/24, e datës 02.04.2024, me të cilin e ka urdhëruar debitorin WBS L.L.C. me seli në Prishtinë, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 11,000.00 EUR (njëmbëdhjetë mijë euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e kalimit të afatit të pagesës së faturës, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, urdhrin për lejimin e përbarimit e ka pranuar me datë 18.06.2024 ndërsa brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor, me arsyetimin se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të faturës nr. 0204/24 për shërbime të konsulencës e

cila është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori, por e njëjta nuk është paguar meqenëse asnjë shërbim nuk është përfunduar nga kreditori, si dhe nuk i është dorëzuar raport për përfundimin e shërbimeve. Tutje, ka shtuar se janë të gatshëm të përmbushin detyrimin ndaj kreditorit, pasi që i njëjti të përfundojë obligimin e tij.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se të njëjtat janë të pa bazuara. Ka shtuar se faturat për shërbime lëshohen pas kryerjes së shërbimit, andaj edhe fatura objekt përmbarimi është lëshuar pasi ka përfunduar shërbimi dhe debitori në momentin e pranimit nuk ka pasur ndonjë vërejtje për shërbimin e kryer. Tutje, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është në origjinal dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, duke qenë e nënshkruar dhe vulosur. Gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 0204/24 e datës 02.04.2024 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi ndaj debitorit, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e evidentuar tek pranuesi i faturës, dhe po ashtu fatura i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me

nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve taksative të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1065/24, datë 26.11.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.